



BASHKIA  
TIRANË

## SHTOJCË

Sot më datë 12.03.2020, Njësia e Prokurimit ju bën me dije se:

Autoriteti Kontraktor, në mbështetje të Nenit 42, pika 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut VII, Neni 62, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), me nismën e vet, vendosi të bëjë ndryshimet në dokumentat e tenderit përmes hartimit të një Shtojce, për procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonceptimi i kopshtit zoologjik” me fond limit: 702,223,384.20 (shtatëqind e dy milion e dyqind e njëzet e tre mijë e treqind e tetëdhjetë e katër pikë njëzet) lekë pa TVSH.

Gjate konvertimit të dokumentit “Preventiv” janë fshirë disa zëra punimesh, konkretisht tek seksioni A-18-1 “Punime ujësjellësi”, zëri 17 dhe 18, dhe tek seksioni A-18-2 “Montim makineri e pajisje ujësjellësi dhe drenazhimi”, zëri 2 dhe 4.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit vendosi të bëjë plotësimet përkatëse në preventiv për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonceptimi i Kopshtit Zoologjik” duke ripublikuar preventivin e plotësuar.

Njësia e Prokurimit njofton të gjithë Operatorët ekonomik pjesëmarrës se afati kohor për dorëzimin e ofertave zgjatet me 20 ditë kalendarike nga ku 5 (pesë) ditë kalendarike lidhur me plotësimet përkatëse në preventiv dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike në zbatim të njoftimit nr.2245.prot, datë 12.03.2020, të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Sa me sipër, afati kohor për dorëzimin e ofertave për objektin: “Rikonceptimi i Kopshtit Zoologjik”, bëhet si më poshtë vijon:

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

**Data: 14.04.2020, Ora: 10:00**

Vendi: Në faqen zyrtare të ëeb-it të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

**Data: 14.04.2020, Ora: 10:00**

Vendi: Në faqen zyrtare të ëeb-it të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**Kjo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë Operatorëve ekonomikë në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik duke u bërë detyruese për ta.**